

BREAKING NEWS

x

PO DARKONTE ME PARTNEREN E TIJ! EKZEKUTOHET SHQIPTARI NE MES TE RESTORA...

AKTUALITET

Selenicë/ Breshëri plumbash banesës së drejtorit të shërbimeve publike në bashki

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
22 MAJ 2019[Facebook](#)[WhatsApp](#)[Twitter](#)[Email](#)

Disa të shtëna me breshëri kallashnikovi kanë tmerruar familjen e Drejtorit të Shërbimeve në Bashkinë e Selenicës pak pas mesnatës së të hënës. Persona ende të pidentifikuara kanë hapur zjarr me breshëri ndaj banesës së 26-vjeçarit Xhulio Mara. Ngjarja ka ndodhur në Selenicë të Vlorës, në orët e para të mëngjesit, rreth orës 01:00. Fatmirësisht nga të shtënat nuk pati persona të lënduar. Familja Mara e tmerruar nga breshëria e plumbave ka lajmëruar menjëherë policinë e Vlorës e cila ka shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes. Në murin rrethues, por edhe pjesët e tjera duken shenjat e plumbave që zbrazën nga armët mbrëmë autorët. Marra është person pa precedent penal dhe prej tre vitesh punon në Bashkinë e Selenicës, që drejtohet nga Përparim Shametaj i zgjedhur nga PD-ja. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje ku po kryen veprimet e mëtejshme hetimore në lidhje me identifikimin dhe kapjen e autorit, por deri tani nuk ka asnjë të ndaluar. Ngjarja duket se ka qenë një paralajmërim për Marrën, por ai mohon që të ketë konflikte.

Dëshmia e 26-vjeçarit

Pas ngjarjes së rëndë shefi i Shërbimeve Publike në Bashkinë e Selenicës është shoqëruar në polici për tu marrë në pyetje në mënyrë që grupi hetimor të mësojë më shumë rreth konflikteve të tij. Por, i riu ka mohuar se ka pasur ndonjëherë konflikte apo është kërcënuar ndonjëherë nga persona të tjerë. Xhuljo Mara thotë se nuk ka konflikte me njeri dhe as borxhe, ndaj nuk di se kujt ti drejtojë gishtin për të shtënat me armë zjarri drejt banesës së tij. Burime nga policia e qytetit bregdetar të Vlorës bëjnë me dije se Mara ka qenë i tronditur për ngjarjen dhe sipas uniformave blu ai ka qenë në gjendje të rëndë psikologjike. I riu mban detyrën e drejtorit të Shërbimeve Publike në Bashkinë e Selenicës, por mohon që të ketë konflikte për shkak të postit të tij. Të shtënat u shënuan rreth orës 01:00 pas mesnatës së lënë pas, ku u qëllua me armë zjarri në pjesën e jashtme të murit të banesës së tij. Fatmirësisht si pasojë e të shtënave nuk ka persona të lënduar. Të

njëjtën gjë 26-vjeçari ka thënë dhe përpara mediave mëngjesin e djeshëm disa orë pas ngjarjes. “Më kanë qëlluar me rreth 20 plumba drejt banesës. Plumbat kanë hyrë edhe brenda në banesë. Nuk kam konflikte, s’kam pasur kërcënime më përpara”, tha ai. Grupi hetimor i policisë së Vlorës ndodhet në vendngjarje, ku po kryen veprimet në lidhje me identifikimin dhe kapjen e autorit.

Hetimet

Sulmi për shkak të detyrës është pista kryesore e hetimeve për breshërinë e plumbave të qëlluar në orët e para të mëngjesit ndaj banesës së Drejtorit të Shërbimeve në Bashkinë e Selenicës. Policia e Vlorës në bashkëpunim me prokurorinë e qytetit bregdetar nisën hetime të menjëhershme në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Selenicë, ku u sulmua me breshëri kallashnikovi banesa e drejtorit të shërbimit publik. Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se në banesën e 26 vjeçarit janë gjetur plot 22 gëzhoja kallashnikovi. Banesa e 26-vjeçarit është sulmuar me dy armë të ndryshme. Edhe pse në dëshminë e tij Mara nuk ka ndihmuar autoritetet duke u shprehur se nuk ka pasur konflikte me njeri dhe se nuk ka marrë asnjëherë kërcënime për shkak të detyrës, grupi hetimor ka dyshime se ngjarja lidhet me detyrën që ushtron 26-vjeçari. Mësohet se Xhuljo Mara njihet në zonë si një person i qetë dhe pa probleme. Gjithashtu drejtori i Bashkisë së Selenicës është person pa precedent të mëparshme penale. Të gjitha këto të dhëna të mbledhura nga grupi hetimor, i kanë shtyrë këta të fundit që ti shtrijnë hetimet tek detyra e të riut. Gjithashtu është sekuestruar dhe një kamër sigurie e cila ndodhet shumë pranë banesës së 26-vjeçarit. Kqyrja e saj do të hedhë më shumë dritë mbi autorët e kësaj ngjarje të rëndë, e cila fatmirësisht përfundoi pa viktima.